



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 549/5 Prot.

Tiranë, më 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 156, Datë 08.06.2026

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 75, datë 13.03.2026, e z. R.Sh kundër Bashkisë Fier, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Deri në vitin 2024 kam qenë përfitues i pagesës së aftësisë së kufizuar (KEMP), për shkak të gjendjes shëndetësore. Aktualisht jam i papunë dhe nuk përfitoj asnjë lloj të ardhure apo mbështetje sociale. Në muajin tetor 2025, kam aplikuar pranë Bashkisë për tu përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike. Pavarësisht kalimit të një periudhë të gjatë kohore, nuk kam marrë asnjë zgjidhje. Në muajin mars 2026, kam aplikuar përsëri për ndihmë ekonomike te Bashkia. Aktualisht banoj në një banesë sociale të dhënë nga Bashkia pa pagesë, gjë që dëshmon se institucioni njuh dhe ka pranuar gjendjen time të vështirë ekonomike dhe sociale”.*

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e ndihmës ekonomike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur nëneni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 549/1, datë 19.03.2026, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar parashtime nga Bashkia Fier, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 3698/1, datë 03.02.2026, Bashkia Fier, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Z. Sh nuk ka qenë trajtuar asnjëherë në skemën e Ndihmës Ekonomike, por ka qenë përfytyes i pagesës së paaftësisë si Invalid Pune, pagesë e cila prej muajit Janar 2025 ka kaluar pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Ka aplikuar për herë të parë në skemë në muajin Dhjetor 2025. Nuk është shpallur fitues dhe është njoftuar të aplikojë përsëri, sipas kuadrit ligjor përkatës. Jemi në pritje të përgjigjes nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier, për muajin Mars 2026, pasi në bazë të VKM nr. 597, datë 04.09.2019, kreu II, pika 9, është kjo Drejtori që realizon procesin e vendimmarrjes brenda muajit përkatës, dhe jo Bashkia. Nëse përsëri sistemi nuk e shpall fitues, do të relatohet në Këshillin e Bashkisë për trajtim nga fondi 6%. Ka shumë kërkesa për trajtim me këtë fond dhe shqyrtimi nga ana jonë është i kujdesshëm. Të kondicionuar nga fondi, jemi munduar të trajtojmë ato familje që janë në kushte shumë të vështira social-ekonomike dhe që sistemi nuk i shpall fitues me motivacionin “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”.

Z. Sh ka bërë një ankesë në datën 11.03.2026 dhe ka marrë një përgjigje për ankesën e tij, me shkresën nr. 3214/1, datë 18.03.2026. Edhe në këtë përgjigje është sqaruar që jemi në pritje të përgjigjes së muajit Mars nga ana e Drejtorisë Rajonale të SHSSH. Siç e theksuam, pas kësaj përgjigje do të relatohet në Këshillin Bashkiak për trajtim nga fondi 6%”.

Me email-in datë 21.05.2026, Bashkia Fier nëpërmjet specialistes së Komisionerit, zyra Fier, ka dërguar dokumentacionin lidhur me hapat e ndërmarrë për trajtimin e çështjes së z. Sh, si më poshtë:

- Këshilli Bashkiak Fier me Vendimin nr. 40, datë 30.04.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6%, për muajin mars 2026”, ka vendosur që R.Sh, të futet në skemën e Ndihmës Ekonomike.
- Drejtoria e Shërbimit Social, e Bashkisë Fier, me shkresën nr. 86, datë 21.05.2026, ka njoftuar z. R.Sh, se do trajtohet me Ndihmë Ekonomike nga fondi 6%, në vlerën 2178 lekë në muaj.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues

Ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.

Neni 7 i këtij ligji parashikon shprehimisht se: “Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

- a. familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;
- b. c. ç. d. ”.

Kategoritë e individëve që mund të aplikojnë për të përfituar ndihmë ekonomike, si dhe mënyrën se si bëhet pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike, përcaktohet shprehimisht në nenin 16, pikat 1-3, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet se:

1. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;

c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në nenin 21, të ligjit sipërcituar, përcaktohet roli i Këshillit Bashkiak: “Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në Vendimin nr. 956, datë 7.12.2016, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike”, parashikohet se formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Në këtë kontekst, është pikërisht sistemi zbatues i kësaj formule, që për zgjedh familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është miratuar Vendimi nr. 597, datë 04.09.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Në pikën 8, të Pjesës II, të VKM-së së sipërcituar parashikohen edhe funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike. Kështu, kjo strukturë ka përgjegjësitë e mëposhtme: a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar, si dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë; b) merr vendime për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si edhe refuzon kërkesën për dhënien e përfitimit të ndihmës ekonomike të shoqëruar me arsyet e refuzimit, sipas formatit në shtojcën 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi; c) ia dërgon vendimin kryetarit të bashkisë për të njoftuar kërkuessit për përfitimin e ndihmës ekonomike ose për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike. Procesi i vendimmarrjes kryhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike. Referuar germës b), të pikës 8, të kësaj VKM-je, duhet vënë në dukje fakti se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror merr vendime në bazë të rezultateve të dala nga sistemi elektronik i pikëzimit, si dhe përcakton masën e përfitimit apo refuzimit të kërkesës së familjeve aplikuese në bazë të parashikimeve ligjore.

Sipas informacionit të Bashkisë Fier, rezulton se z. Sh, ka aplikuar për ndihmë ekonomike pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në muajin dhjetor 2025 dhe mars 2026 dhe nuk është shpallur fitues.

Nga analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara rezulton se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier është përgjegjëse për verifikimin e informacionit të ofruar nga administratorët dhe për miratimin e kërkesave për ndihmë ekonomike.

Refuzimi i ankuesit për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike është kryer nga sistemi përkatës i pikëzimit, i cili bën përzgjedhjen në mënyrë automatike të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Kriteret dhe vlerësimin përkatës e bën sistemi dhe në asnjë rast subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa. Në këtë kontekst, rezulton se Bashkia Fier nuk ka ndikuar në refuzimin e ankuesit si përfitues nga ana e sistemit të pikëzimit.

Pavarësisht sistemit të pikëzimit, legjislacioni parashikon një mekanizëm alternativ mbështetjeje për familjet që nuk rezultojnë përfituese të ndihmës ekonomike përmes këtij sistemi. Konkretisht, Vendimi nr. 597/2019 i Këshillit të Ministrave, në Pjesën IV, parashikon që Këshilli Bashkiak të miratojë në fillim të çdo viti kriteret për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar, duke u garantuar kështu mbështetje edhe familjeve në nevojë që, megjithëse kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistratit Elektronik Kombëtar, nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.

Në kushtet kur ankuesi është refuzuar nga sistemi elektronik i pikëzimit për të qenë përfitues i ndihmës ekonomike, si dhe duke qenë në dijeni të gjendjes së tij ekonomike, Bashkia Fier e ka rekomanduar z. Sh për të përfituar ndihmë ekonomike me fondin shtesë 6% të Bashkisë.

Referuar Vendimit nr. 40, datë 30.04.2026, të Këshillit të Bashkisë Fier “Për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6%, për muajin mars 2026”, rezulton se z. R.Sh është përfitues i ndihmës ekonomike, në masën 2178 lekë/muaj.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se lidhur me çështjen e akordimit të ndihmës ekonomike, e cila është objekt i ankesës së tij, ankuesi në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Fier. Rezulton se Bashkia Fier ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e parashikuara për vlerësimin e kërkesave për ndihmë ekonomike.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Bashkia Fier, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32 e 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. R.Sh, për shkak të gjendjes shoqërore dhe ekonomike, nga ana e Bashkisë Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)